

035 NUMRAT E KONTROLLIT TË REGJISTRIMEVE NË SISTEMET E TJERA

Fusha përmban numrin e kontrollit që i takon regjistrimit në një sistem tjetër.

Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA			PËRSËRITSHMËRIA
035		Numrat e kontrollit të regjistrimeve në sistemet e tjera	r
	a	Numri	nr
	z	Numri i anuluar ose i pavlefshëm	r

Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

035a Numri

Kodi për organizatën e vendosur në kllapa, pas të cilës vjen numri i kontrollit i regjistrimit në bazën e të dhënave të asaj organizate. Rekomandohet vendosja e kodeve nga lista e *MARC Code List for Organizations*, mirëpo mund të përdoret edhe emri i plotë ose kodi kombëtar i institucionit.

035z Numri i anuluar ose i pavlefshëm

Numri i kontrollit i anuluar ose i pavlefshëm në formën e njëjtë sikurse në nënfushën 035a.

SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Numri i kontrollit vendoset në formën e njëjtë sikurse në sistemet e tjera.

FUSHAT NË LIDHSHMËRI

Numri identifikues i regjistrimit

Numri i kontrollit si identifikues uniform i regjistrimit. Numrin e ndanë institucioni që e përgatit regjistrimin.

SHEMBUJ

1.

035	□□	a (CiZaNSB)920701098 (Numri i kontrollit, të cilin e ka ndarë "Nacionalna i sveučilišna knjižnica u Zagrebu".)
-----	----	--

2.

035	□□	a (FrPBN)frBN001148436 (Numri i kontrollit, të cilin e ka ndarë "Bibliothèque nationale in France".)
-----	----	--

3. *

035	□□	a (DE-599)DNB1199215600 (Numri i kontrollit, të cilin e ka ndarë "Deutsche Nationalbibliothek".)
-----	----	--